



**Republika e Kosovës – Republika Kosova**  
**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësues**  
**Izborni Panel za Žalbe i Predstavke**

**Anr. 357/2014**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësues (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Hasan Shala Kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Smajl Latifaj kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) dega në Rahovec, paraqitur kundër Hysni Mullaliu Kryesues i vendvotimit në Rahovec, për shkak të mungesës të votave, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me 16.06.2014, mori këtë:

**V E N D I M**

**HUDHET** si e pas afatshme ankesa e Smajl Latifaj kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK).

**Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë me datë 13.06.2014, nga Smajl Latifaj kandidat për deputet për Kuvendin e Republikës së Kosovës nga radhët e subjektit politik AAK, me numër 28, ku pretendon se në vendvotimin nr.1601A/03R me datën 08.06.2014, gjatë numërimit të votave, Kryesuesi Hysni Mullaliu në meny të pavetëdijshme nuk ja ka vendosur numrin e votave të fituara në atë vendvotim në procesverbalin e votimit, ku i njëjti ka gabuar me kandidatin tjetër të AAK-së, Luan Jaha me nr.61. Pretenduesi i ankesë kërkon sqarim nga ana e PZAP-së.

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi emrin dhe deklaratën e kryesuesit si dhe Formularin e Rezultateve për Kuvendin e Republikës së Kosovës po të atij kryesuesi.

PZAP-i, shqyrtoi afatshmerinë e ankesës, gjeti se:

**Ankesa është e pas afatshme**

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se ankesa është e pas afatshme sepse afati për të parashtruar ankesë në PZAP, për të gjitha parregullsitë që lidhen me ditën e votimit është definuar me nenin 119.1 të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Personi që ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelje ligjore për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë PZAP-it brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”*. Ndërsa ankesa në fjalë është parashtruar në PZAP, me datë 13.06.2014 në ora 14:42, që nënkupton se pala ankuese ankesën e ka parashtruar pas afatit të përcaktuar sipas dispozitës së sipërshtuar, andaj duke u bazuar nenin 118.1 të LZP-së, PZAP-i vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa**

Anr. 357/2014 më datën 16.06.2014

**Kryesuesi i Panelit  
Hasan Shala**



**Këshillë juridike:** PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.